



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 758/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Plator Asllani, kandidat për anëtarë në Kuvendin Komunal në Komunën e Obiliqit, nga radhët e Iniciativës Qytetare Obiliq e certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, të paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të dt.03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rezultatin përfundimtar të publikuar me datë 03.11.2021, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 17.10.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli: Anr.758/2021, i paraqitur nga Plator Asllani, kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal në Komunën e Obiliqit nga radhët e Iniciativës Qytetare Obiliq e certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për anëtar të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Plator Asllani, në vendvotimet: 1501e/09D, 1510e/01R, 1510e/02R, 1520e/01R, 1520e/02D, 1502e/01R, 1502e/02R, 1502e/03R, 1502e/04R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, me datën 04.11.2021 ka pranuar apelin Anr.758/2021 të parashtruar nga Plator Asllani, kandidat për anëtarë në Kuvendin Komunal në Komunën e Obiliqit nga radhët e Iniciativës Qytetare Obiliq me të cilën pretendon se pas publikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit nga radhët e Iniciativës Qytetare për Obiliq, me numrin 20, është bërë shkelje e dispozitave ligjore nga ana e komisionerëve dhe vëzhguesve në disa vendvotime të cekura në apel. Parashtruesi i apelit thekson se në të gjitha paralogaritjet del se në vendvotimet ku kanë votuar familjarët dhe përkrahësit e tij, nuk i figurojnë votat në formularët e rezultateve të zgjedhjeve me të cilën thekson se për këto parregullsi i dëshmon edhe përmes deklaratave të dëshmitarëve. Kërkon që ti rinumërohen votat në vendvotimet 1501e/09D, 1510e/01R, 1510e/02R, 1520e/01R, 1520e/02D, 1502e/01R, 1502e/02R, 1502e/03R, 1502e/04R Parashtruesi ka bashkangjitur disa deklarata të dëshmitarëve për VV e cekura në apel.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

-apeli është i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialet zgjedhore, ka konstatuar se ka mungesë të votave të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Iniciativa Qytetare Obiliq, Plator Asllani me provat e ofruara nga pala ankuuese, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vet pala ankuuese.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se mungesa e votave në formularët FPR, është bërë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me pa rregullsi nga ana e anëtarëve në KVV të cilët kanë bërë gabime në shënimin e votave.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për kandidatin për anëtarë në Kuvendin Komunal në Komunën e Obiliqit për vendvotimet e cekura si në dispozitivin II dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 17.10.2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve, të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilë dispozitë përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 758/2021 më datën 05.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.